

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Kryebashkiaku Xhelal Mziu, takim me ambasadorin zviceran, Christoph Graf



FAQE 4

SOCIALE

Fondi për shtresat në nevojë, pjesë e buxhetit 2017 të Bashkisë Kamëz



FAQE 5

INVESTIMET NË PASKUQAN

Së shpejti nis ndërtimi i rrugës "Arben Broci" bashkë me kanalizimet



FAQE 7

SPORT

Kamza vijon e pandalshme rrugëtimin drejt Superligës, fiton edhe me Kastriotin



FAQE 8



Gazetë e Bashkisë Kamëz
KAMZA

E përdyjavshme
Nr. 195 shkurt 2017
Çmimi 20 lekë
drmediakamez@gmail.com
www.kamza.gov.al

Protesta e 18 shkurtit
Ose zgjedhje të lira, ose zgjedhje nuk do të ketë

FAQE 2-3

Reagim ndaj shpifjes së radhës të kolegut mashtrues të Tiranës!

Faqe 4

Kamëz, në shkurt qeveria heq 300 familje nga ndihma ekonomike

Faqe 5

Bum investimesh në Paskuqan për vitin 2017

Faqe 7

Rruga e Zanave në lagjen nr. 1 Bathore, investim i Bashkisë Kamëz për vitin 2017

Faqe 6



Basha në Kamëz: Në qeverinë time s'ka për të pasur asnjë familje pa bukë, pa ujë, pa drita

FAQE 3



NË BRENDESI

Vijojnë projektet e Bashkisë Kamëz për përmirësimin e infrastrukturës urbane

FAQE 4

Vazhdimi i rrugës "Liria" në Frutikulturë, tjetër investim madhor për vitin 2017

FAQE 7

Kryebashkiaku dhe kryetari i PD Kamëz, Mziu: Kjo qeveri nuk ka bërë asgjë gjatë këtyre viteve

FAQE 5

Ndërtimi i rrugës "Burreli" në lagjen nr. 1 Bathore, projekt me ndikim të madh social

FAQE 7

Kamza Basket e nis me fitore fazën e dytë, mund Teutën në transfertë 78 - 86

FAQE 8



Ose zgjedhje të lira, ose zgjedhje nuk do të ketë

Lulzim Basha

Nga Tirana dhe nga gjithë Shqipëria, shqiptarë të ndershëm, shqiptarë të lirë, bashkimi më i madh popullor që ka njohur ndonjëherë ky vend, është derdhur sot këtu në këtë shesh, sheshin e lirisë, sheshin e protestës, sheshin e vendimit të madh për Shqipërinë dhe gjithë shqiptarët.

Mirësevini!

Ne jemi mbledhur sot këtu, ju keni ardhur sot këtu, sepse kjo qeveri e ka çuar vendin në mjerim, në varfëri dhe kaos, dhe tani që ju ka vjedhur gjithçka nga xhepat dhe shtëpitë tuaja, do t'ju vjedhë edhe zgjedhjet.

Ju të gjithë e dini mirë këtë.

Ju, ne jemi mbledhur sot këtu për të thënë: Boll më! Boll kemi duruar ato që durojmë përditë që kur erdhën këta në pushtet.

Sot, ne nisim rrugëtimin drejt një fillimi të ri për të cilën vendi ka qarkulluar shumë nevojë, për të cilin ka nevojë qarkulluar shumë çdo shqiptar, për të cilin ka nevojë çdo fëmijë, i ri dhe e re.

Sot jemi këtu për ta shpallur këtë vendim me zë të lartë: Po, duam zgjedhje të lira dhe të ndershme!

Duam ndarjen e politikës nga krimi!

Duam dinjitet!

Duam drejtësi!

Duam punë!

Duam ta vëmë interesin e njerëzve të thjeshtë të parin!

Duam një të ardhme dinjitoze që na bën krenarë për vendin tonë!

Duam shpresën, shpresën që po lind, nga ky bashkim më i madh në historinë e shqiptarëve.

Vendimi për të ndaluar maskaradën e grabitjes së zgjedhjeve

Sot jemi të bashkuar në këtë shesh sepse nuk e pranojmë dot më këtë gjendje; jemi të bashkuar sepse kemi besim se mund të ndërtojmë një jetë dinjitoze; jemi të bashkuar nga alarmi kombëtar dhe ndërkombëtar se pushteti i korruptuar dhe kriminelët duan të vjedhin zgjedhjet e ardhshme.

Sot jemi bashkuar për të marrë një vendim të madh, vendimin për të ndaluar njëherë e mirë maskaradën e grabitjes së zgjedhjeve.

Ose do të bëjmë zgjedhje të lira ose zgjedhje nuk do të ketë.

Rrugë të mesme nuk ka. Rrugë tjetër nuk ka.

Zgjedhjet për fasadë, zgjedhjet e njollosura nuk do t'i pranojmë.

Zgjedhjet e standardeve të krimit në vend të standardeve të Evropës nuk do t'i pranojmë.

Zgjedhje me kriminelë të veshur me pushtet nuk do t'i pranojmë.

Zgjedhje që shtrembërojnë vullnetin tuaj, vullnetin e shqiptarëve nuk do të ketë më në Shqipëri.

Partia Demokratike lindi në rrugë dhe në shesh, me ju popullin në krah.

Partia Demokratike lindi sepse e deshët ju, qytetarët e këtij vendi.

27 vite më parë, shqiptarët kishin nevojë për një lëvizje të madhe demokratike.

Sot, ne prapë kemi nevojë për një lëvizje të madhe kombëtare dhe demokratike.

Kjo qeveri palaçosh ka dështuar! Ju e dini këtë!

Kjo mazhorancë është një dështim total! Ju e vuani këtë!



Ky kryeministër është turpi i vendit! Ju e shihni këtë!

Garanci që qytetarët të ndihen të mbrojtur

Sot, ne nisim kthimin e Shqipërisë, sot ne nisim kthimin e vendit tonë në rrugën e sigurtë drejt të ardhmes.

Unë jam këtu, me ju, sepse dua që ju, njerëzit e lirë, shqiptarët e lirë, të jeni të parët për qeverinë e re që duam të kemi për Shqipërinë tonë.



Unë dua që ju, të jeni krenarë për vendin tuaj. Unë dua që ju të jeni e të ndiheni të sigurtë. Unë dua që ju të jeni e të ndiheni të mbrojtur. Të mbrojtur nga arroganca. Të mbrojtur nga padrejtësia. Të mbrojtur nga varfëria. Të mbrojtur nga korrupsioni dhe krimi. Të mbrojtur nga propaganda. Të mbrojtur nga ky sistem i pashpirt e i padrejtë.

Po, jam sot këtu sepse dua t'ju mbroj nga politika që i shërben krimit dhe jo ju. Politikanët e lidhur me krimin po e shkatërrojnë vendin. Ata po ju shkatërrojnë jetën. Droga nuk është e ardhmja e Shqipërisë. Korrupsioni nuk është e ardhmja e Shqipërisë.

Krimi i organizuar nuk është e ardhmja e Shqipërisë. Papunësia nuk është e ardhmja e Shqipërisë. Varfëria nuk është e ardhmja e Shqipërisë. Emigrimi nuk është e ardhmja e Shqipërisë. Kjo qeveri nuk është e ardhmja e Shqipërisë! Bashkëqytetarët e mi, Shqipëria po shkatërrohet. Shqipëria po shkatërrohet

sepse ky sistem nuk punon. Shqipëria po shkatërrohet sepse kjo qeveri nuk punon për njerëzit. Ata punojnë vetëm për veten e tyre, vetëm për xhepat e tyre.

Ata dështuan për të sjellin një jetë më të mirë për shqiptarët. Një grusht pushtetarësh dhe kriminelësh, po gëzojnë gjithçka, ndërsa shqiptarët po marrin rrugët e botës. Shqipëria është bërë sot hambar i krimit dhe i drogës.

Ata dështuan dhe mashtruan me 300 mijë vendet e punës. Ata dështuan dhe mashtruan me shëndetësinë falas. Ata dështuan me

demokracinë e vërtetë. Dështuan me lirinë e vërtetë.

Si mund të jenë të lirë njerëzit kur kanë frikë për të nesërmen? Frikë për të ardhmen e fëmijëve.

Frikë për shëndetin. Frikë se do të humbasin ose nuk do e gjejnë kurrë një vend pune.

Frikë nga taksidari që u vjen tek biznesi dhe ua mbyll. Frikë nga kriminelët e veshur me pushtet.

Frikë për të votuar të lirë.

Frikë se do t'ju duhet të lënë shtëpitë e tyre, për të nisur një jetë të vështirë, plot të panjohura në emigracion.

Qeveria Rama detyroi 300 mijë shqiptarë të braktisin vendin

Kjo qeverisje ka detyruar 300 mijë shqiptarë të braktisin vendin, kjo duhet të marrë fund!

Ne kemi qenë në pushtet dhe kemi qeverisur. E dimë sa e vështirë është. E dimë që duhet kurajo, për të marrë vendimin e duhur, çdo ditë. Ne u përpoqëm ta përmirësojmë jetën për njerëzit. Në fakt ne e bëmë këtë.

Ne e vendosëm Shqipërinë në vëmendjen ndërkombëtare, e futëm në NATO, hoqëm vizat. Ne punuam fort për të ruajtur vlerat tona, lirinë, taksat e ulëta, investimet madhore në infrastrukturë.

Ne punuam për të mirën e vendit tonë.

A bëmë mjaftueshëm? Jo. Por a e shkretuam vendin kështu? A lamë fatin tuaj në dorë të krimit dhe kriminelëve? Jo.

A jemi ne ndryshe nga këta? Po!

Sot, dua të ndaj diçka me ju dhe mendoj se ka ardhur koha ta dëgjoni. Unë jam gati!

Jam gati, t'ju udhëheq në rrugën që na nxjerr nga ky kaos- drejt së ardhmes. Jam gati të ndërtoj me ju, për ju, një shoqëri të re, një vend të ri, një të ardhme të re për çdo shqiptar të ndershëm.

Po, jam gati. Sot, më shumë se kurrë. Tani, kam një pyetje të thjeshtë për ju, për ju qindra, mijëra shqiptarë në këtë bashkim më të madhin popullor në histori dhe për shqiptarët anëmbanë vendit:

A jeni gati të luftojmë bashkë? Të luftojmë bashkë për Shqipërinë? Të ngrihemi bashkë për zgjedhje të lira?

Për të shpërrur qeverinë e krimit, për të shpërrur qeverinë e korrupsionit.

Bashkë për një qeveri të njerëzve? Bashkë për një qeveri të qytetarëve? Le të nisim sot, jo nesër. Sot, sot, sot, lëvizjen e madhe kombëtare dhe demokratike për të cilën Shqipëria ka qarkulluar shumë nevojë. Sot, qëndroju këtu bashkë me ju për t'ju dhënë fjalën se do të punoj pa pushim për të përmbushur aspiratën tonë të përbashkët që gjithsecili prej jush të bëjë realitet ëndrrën e tij për një jetë më të mirë për veten tuaj dhe për familjen tuaj.

Sot është dita kur nisim marshimin drejt këtij qëllimi! Ky qëllim është më i madh se gjithsecili prej nesh. Më i madh se qëllimet e një partie politike. Më i madh edhe se qëllimet e koalicionit tonë. Shumë më i madh se rrotacioni politik i radhës nga e kuqe në blu apo nga blu në të kuqe.

Sepse ka të bëjë me vendin tonë. Sepse ka të bëjë me njerëzit tanë. Ka të bëjë me të ardhmen tonë. Ka të bëjë me vendimin që ne vetë, ne vetë dhe askush tjetër të mos vendosë për fatin tonë! Miqtë e mi, gjithçka në jetë varet nga vendimet që ne marrim.

Sot, bashkë do ta marrim një vendim të madh! Ky vendim është në dorën tuaj.

Kjo që po ndodh në Shqipëri nuk është fatalitet i pashmangshëm.

Ju, njerëzit e thjeshtë të këtij vendi, e keni shkruar një herë historinë.

Unë e mbaj mend si të ishte dje, 8 dhjetorin 1990, atë ditë ne morëm një vendim, vendimin se nuk mund të vazhdonim më si më parë.

Vendimin për t'u ngritur kundër krimit dhe tiranisë shtetërore, vendimin për të zgjedhur lirinë! Sot unë dua që ju, të gjithë bashkë, të marrim një vendim tjetër të madh. Thellë brenda vetes, e dimë se kështu nuk mund të vazhdojmë më.

Sot, ne vendosim:

Ose vendi do të vazhdojë kështu, dhe ne do të zhytemi përditë e më shumë në varfëri dhe kaos;



Ose ne, do të hapim një derë të re drejt të ardhmes, një derë që na çon në një fillim të ri për vendin tonë, mundësi të reja për një jetë më të mirë. Ky është një vendim i madh, sepse është një vendim i vështirë.

Ky vendim kërkon nga të gjithë ne këtu në këtë shesh dhe anembanë Shqipërisë

të zgjedhim mes frikës ose kurajos, mes indiferencës ose përgjegjësisë, mes oportunitizmit ose sakrificës.

Në shesh deri në krijimin e një qeverie teknike

Unë kam vendosur të zgjedh kurajon! Unë

kam vendosur të zgjedh përgjegjësinë! Unë kam vendosur të zgjedh sakrificën! Ka ardhur koha miqtë e mi. Ka ardhur koha të marrim vendimin e madh.

Vendimin për të bërë realitet ëndrrat tona. Vendimin për t'u ngritur bashkë! Vendimin për të vrarë frikën dhe për të zgjuar shpresën për të cilën Shqipëria sot ka nevojë. Vendimin për të caktuar vetë fatin e fëmijëve tanë.

Vendimin për të shpallur se ky vend i lashtë ka çfarë t'i ofrojë popullit të vet, ka çfarë t'i ofrojë Evropës.

Vendimin për të vënë punën e ndershme, mirëqenien, demokracinë e vërtetë, në themelet e reja të Shqipërisë.

Vendimin, miqtë e mi, për të bashkuar, për të bindur, të gjithë ata që e duan Shqipërinë me zemër.

Vendimin për të dekriminalizuar shtetin, vendimin për të zhdukur ekonominë e drogës, vendimin për t'u kthyer njerëzve fuqinë ekonomike, vendimin për t'iu kthyer njerëzve pushtetin.

Ne do të qëndrojmë këtu në këtë shesh derisa të sigurojmë njëherë e mirë zgjedhje të lira e të ndershme.

Ne do të qëndrojmë në këtë shesh dhe nuk



do të lejojmë zgjedhje fasadë me këtë qeveri të kapur nga droga dhe krimi.

Unë do të qëndroj këtu në shesh. Ju ftoj të gjithëve të qëndrojmë së bashku!

Të qëndrojmë së bashku për të realizuar zgjedhje të lira dhe të ndershme, të cilat vijnë vetëm përmes shporrjes së qeverisë së krimit dhe një qeverie teknike të zgjedhjeve të lira.

Ky është vendimi im.

A është ky vendimi i të gjithëve këtu sot?

Fitorja është në zemrën e gjithsecilit prej jush!

Kjo do të jetë fitorja më e bukur sepse do të jetë fitorja juaj!

Ne ngrihemi bashkë!

Ne fitojmë bashkë!

Shqipëria fiton me ne!

Zoti ju bekoftë ju!

Zoti e bekoftë Shqipërinë!

Lulzim Basha në Kamëz: Në qeverinë time s'ka për të pasur asnjë familje pa bukë, pa ujë, pa drita

“Për familjet në nevojë ekonomike, 200 kilovatë në muaj do t'i paguajë buxheti i shtetit”

Kryetari i Partisë Demokratike, z. Lulzim Basha, i shoqëruar nga kryebashkiaku dhe kryetari i PD Kamëz, z. Xhelal Mziu, zhvilloi një takim me qytetarë të Kamzës, si dhe vizitoi disa familje në nevojë. Ai bisedoi me ta për gjendjen dhe vështirësitë e mëdha ekonomike dhe jetësore që kalon shumica e zonës së Kamzës, për shkak të papunësisë dhe të braktisjes së tyre nga shteti.

“Sot kam vizituar familjen e Shyqyri Durishtit, kryefamiljar me pesë fëmijë, njëri prej të cilëve në nevojë akute shëndetësore, ka nevojë për operacion, i cili ka gjashtë muaj pa drita. Ka gjashtë muaj pa drita, sepse nuk arrin të paguajë faturat e fryra, sa nga çmimi i energjisë, sa nga abuzimi i OSHEE-së. Është pa punë, ai dhe e shoqja e tij. Janë pa punë pesë fëmijët e tij, disa janë në moshë minore, por nuk merr ndihmë ekonomike, sepse njësoj si pesë mijë familje të tjera të Kamzës, janë hequr nga lista e ndihmës ekonomike. Janë hequr nga lista e ndihmës ekonomike si dhjetëra mijëra familje sot anembanë Shqipërisë, të cilat nuk arrijnë të paguajnë bukën e fëmijëve, nuk arrijnë të paguajnë dritën, energjinë, për të pasur dritë për fëmijët e tyre”, - u shpreh z. Basha.

“Katër vjet më parë, këtu, Edi Rama premtoi që do të bënte gjithçka për të pamundurit, për shtresat në nevojë, se do të ulte taksat, se do t'u vinte në ndihmë, se do të rriste ndihmën ekonomike. Taksat u rritën, çmimet u rritën, çmimi i energjisë u rrit.

Asnjë nga familjet nuk ka pasur rritje të ndihmës ekonomike. Mijëra familje janë larguar nga skema e ndihmës ekonomike. Paratë e taksave të rritura, e faturave të rritura nuk kanë shkuar për të ndërtuar asnjë shkollë, asnjë spital, asnjë kilometër rrugë, as për rritje pensionesh, as për rritje të ndihmës ekonomike, as për të hapur vende pune. Në fakt, - tha z. Basha, - familjet janë shtyrë drejt dëshpërimit, drejt emigracionit. Kryefamiljarët janë shtyrë, me dhjetëra prej tyre, drejt vetëvrasjes, se nuk ka dhimbje më të madhe për një prind sesa të mos sigurojë



dot dritat natën për fëmijët e tij apo bukën e gojës.

Kjo është gjendja. Futuni në këto shtëpi! Ju

medias, ju bëj thirrje, jo vetëm te Shyqyri. Futuni nëpër të gjitha këto shtëpi dhe shikoni se si është gjendja! E nuk ka nevojë të jemi

këtu, kudo në Shqipëri, edhe në qendër të Tiranës, me mijëra familje janë sot në kufijtë e ekzistencës, në kufijtë e dëshpërimit, sepse paratë e taksave të rritura, paratë e faturave të rritura të energjisë përfundojnë në xhepat e një grushti njerëzish të lidhur me Edi Ramën. Përfundojnë në xhepat e pushtetarëve të korruptuar dhe të lidhur me krimin. Qytetarët janë braktisur nga kjo qeveri dhe kjo qeveri i shërben vetës së vet dhe një grushti njerëzish që pasurohen ditë për ditë mbi taksat, djersën, gjakun dhe vuajtjen e shqiptarëve”.

“Prandaj nuk do zgjidhje të lira e të ndershme, - vijoi Basha, - se i lipset ta mbajë kështu vendin. Prandaj duhet të ngrihemi më 18 shkurt për t'i dhënë vendit zgjedhje të lira, të ndershme e një qeveri të qytetarëve. Në qeverinë time s'ka për të pasur asnjë familje pa bukë, pa ujë, pa drita. Për familjet në nevojë ekonomike 200 kilovatë në muaj do t'i paguajë buxheti i shtetit. I ka të gjitha mundësitë shteti t'u vijë në ndihmë familjeve të pamundura, po të mos i bëjnë paret rrush e kumbulla, po të mos i ndajnë paret me miqtë e Kryeministrit. Këtë do të bëjmë së bashku”, - u shpreh kreu i PD-së. Më tej ai tha: “Por, së pari, duhet të garantojmë votën. Duhet të garantojmë zgjedhje të lira e të ndershme nëpërmjet zgjedhjeve të lira e të ndershme e një qeveri për qytetarët. Prandaj është e rëndësishme të mblidhemi të gjithë më 18 shkurt! Të gjithë në shesh me pjesëmarrje masive! Të bëjmë atë që bën çdo komb i civilizuar, siç e bënë rumunët. I patë rumunët apo jo? Nuk ka qeveri të inkriminuar, të korruptuar t'i bëjë ballë, kur ngrihen qytetarët, kur ngrihet rinia. Ndaj, edhe për Shyqyriun, edhe për ata qindra e mijëra familje të tjera, për pensionistët, për rininë, këtë mesazh kam: Të ngrihemi bashkë më 18 shkurt dhe me fuqinë e bashkimit t'i diktojmë zgjedhje të lira e të ndershme e një qeverisje për qytetarët. Thirrja ime është: Të bashkohemi të gjithë! Më 18 shkurt të ngrihemi bashkë në Tiranë e në gjithë Shqipërinë! Zgjedhje të lira e të ndershme, qeveri për qytetarët! Ky është premtimi ynë”.



Kryebashkiaku Xhelal Mziu, takim me ambasadorin zviceran, Christoph Graf

Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, pati një takim me ambasadorin zviceran në Shqipëri, z. Christoph Graf, takim i cili u zhvillua në mjediset e Ambasadës Zvicerane në Tiranë. Ambasadori Zviceran, pasi shprehu kënaqësinë për këtë takim, duke theksuar mbështetjen për pushtetin vendor, ndër të tjera, e përgëzoi kryebashkiakun Mziu për rolin që luan në Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë. “Jam i kënaqur që keni arritur këtu. Ne ofrojmë mbështetje për pushtetin vendor. Ju përgëzoj për rolin konstruktiv në Shoqatën e Bashkive”, - u z. Graf.

Ndërkaq, kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, u shpreh se ndihet i privilegjuar që ndodhet në këtë takim, duke e njohur pastaj ambasadorin zviceran me zhvillimet e qytetit të Kamzës. “Ndihehem shumë i privilegjuar që ndodhem këtu. Po shfrytëzoj rastin për të bërë një rezymë të vogël për qytetin e Kamzës. Të jesh kryetar Bashkie në Kamëz ka vështirësitë e veta. Dy gjëra janë sfidë për mua: 1-Infrastruktura (kalimi i saj nga rurale në urbane); 2-Menaxhimi dhe shërbimi ndaj qytetarëve. Situata më përpara ka qenë shumë e keqe, ndërsa tashmë ka ndryshuar, për shkak të punës që ka bërë Bashkia, si dhe falë bashkëpunimit me donatorë të huaj të ndryshëm. Gjej rastin t’ju falënderoj ju si ambasador, por edhe Zvicrën, pasi është financuese e projektit të ujësjellësit. Kamza ka shfrytëzuar partneritetin me të huajt për shumë projekte, jo vetëm në ujësjellës. Kemi pasur shumë partnerë, të cilët kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për nevojat e Kamzës”, - u shpreh z. Mziu, i cili vijoi më tej: “Pavarësisht se Kamza dhe Paskuqani kanë dy plane sipas ligjit urbanistikë, ato nuk janë aktive, për shkak të mosnifikimit. Nuk jemi pjesë e projektit të 26 bashkive, duke krijuar kështu edhe konflikte me qytetarët. Kërkoj mbështetjen tuaj, jo vetëm si ambasador, por edhe si vend mik, në zgjidhjen e këtij ngërçi për të eliminuar këto konflikte me qytetarët, por edhe për të pasur një barazi me njësitë e tjera vendore. Kërkoj influencën tuaj si ambasador



për të shmangur këto diferencime krahasuar me njësitë e tjera vendore. Vlen të theksoj se kemi dërguar shumë projekte në qeveri për shumë fusha jetike për banorët, por kemi marrë 0 financime”, - u shpreh z. Mziu, duke e informuar më tej ambasadorin Graf se për ndër të këtij vendi mik, siç është

**“ Ambasadori Graf:
Po përgatisim një
program për 10 vite,
që edhe Kamza të jetë
përfituese. Garantoj se
do të jemi të gatshëm për
t’ju mbështetur dhe për
të gjetur zgjidhje për të
gjitha problematikat. ”**

Zvicra, në Kamëz ka dy rrugë me emra nga ky shtet, rruga “Gjenevë” dhe rruga “Zyrih”.

Ambasadori Graf, pas këtij prezantimi, u shpreh: “Ju falënderoj për prezantimin, sfidat dhe problemet e Kamzës! Unë po e kuptoj qartë nga informacionet që ju më dhatë për diskriminimin e Kamzës dhe këto informacione në nivele politike sa të më jepet mundësi do t’i bëj të ditur, do t’i vë në dispozicion. Po përgatisim një program për 10 vite, që edhe Kamza të jetë përfituese. Garantoj se do të jemi të gatshëm për t’ju mbështetur dhe për të gjetur zgjidhje për të gjitha problematikat që ju ngritët. Ju garantoj se do t’ju ndihmoj për të bashkëpunuar”, - kanë qenë fjalët e ambasadorit zviceran në Shqipëri, z. Christoph Graf.

Reagimi ndaj shpifjes së radhës të kolegut mashtrues të Tiranës!

Është e qartë se nuk mund ta njohësh realitetin, kur je 3 ditë jashtë e 1 ditë në punë. Kjo i ka ndodhur Veliajt, i cili, edhe pse prej dy vitesh është në krye të Bashkisë së Tiranës, nuk njeh ende kufijtë territorialë; edhe pse ndarja është bërë me ishuj, kujtojmë qytetarët e Zall-Herrit duhet të kalojnë nëpër Kamëz për të shkuar në qendrën e Njësisë Administrative Tiranë, ndarje politike! Drejtoria e UKT-së, ku ka bërë analizën kolegu mashtrues i Tiranës, është në territorin e Kamzës

Kamza, por janë marrë padrejtësisht nga Tirana, si:

- repartin e zjarrfikëseve të Kamzës;
- makineritë dhe financimin e kullimit dhe vaditjes që i takonte Kamzës;
- konviktin e shkollës së mesme që i takonte Kamzës;
- fondin e mirëmbajtjes së rrugëve që i takonte Kamzës;
- administrimin e pyjeve që i takonte Kamzës.

Fakt është se Kamza ka aplikuar për 4 vite



(që brenda pranverës do të merret nga Bashkia Kamëz), por tubacioni që kalon nga impianti i Bovillës drejt Tiranës menaxhohet nga UKT-ja e tij, pra nëse ka abuzim apo vjedhje, faji është i turistit më luksoz në Shqipëri, kreut të Bashkisë së Tiranës. Sepse, është nën menaxhimin e tij.

Ku e gjen kurajën kolegu mashtrues që çdo ditë merr nën mbrojtjen politike të qeverisë: territore padrejtësisht nga Kamza; pyje nga Kamza; që merr funksione të deleguara nga qeveria që duhet t’i merrte

mbi 120 projekte tek qeveria, të refuzuara të gjitha, ndërsa Bashkia e Tiranës ka marrë 33,5 herë më shumë lekë për frymë për banorët e Tiranës. A nuk janë njësoj banorë, me të drejta të njëjta si në Kamëz, si në Tiranë? Kjo është e vërteta.

Veliaj ka kapur mediat dhe çdo mashtrim i tij bëhet lajm. Po realiteti që prekin dhe njohin qytetarët nuk ndryshohet me propagandë të rreme. Realiteti ndryshon duke u shërbyer njerëzve, pavarësisht ku banojnë dhe për kë votojnë.

Kryebashkiaku dhe kryetari i PD Kamëz, Xhelal Mziu: Kjo qeveri nuk ka bërë asgjë gjatë këtyre viteve

Në takimet e zhvilluara me qytetarët, kryebashkiaku dhe kryetari i PD Kamëz, z. Xhelal Mziu, është shprehur se kjo qeveri nuk ka bërë asgjë gjatë këtyre viteve. Ai i ka falënderuar bashkëqytetarët e tij për këtë pjesëmarrje masive në takime, gjë që

familje, hiqen padrejtësisht. Premtoi edhe investime, por deri tani asnjë qindarkë investime s’ka bërë kjo qeveri.

Kjo gjendje ka bërë të pakënaqur edhe vetë socialistët.

Ndaj, ky është momenti që me datë 18



tregonte masivitetin që do të kishte protesta që u zhvilluar më datë 18 shkurt. “Gjatë kësaj kohe kam takuar shumë qytetarë të cilët kanë shprehur dëshirën për protestë ndaj qeverisë. Tani është momenti i duhur për të goditur këtë qeveri. Kjo qeveri nuk ka bërë asgjë gjatë këtyre viteve dhe është shumë larg qeverisjes prej 8 vitesh të PD-së”, - është shprehur z. Mziu në një nga takimet e zhvilluara me qytetarët. “Premtuan 300 mijë vende pune, por i larguan jashtë shtetit. Premtuan edhe nga sheshi i Kamzës, por nuk mbajtën asnjë premtim. Deri në vitin 2013 kanë qenë 7300 familje që trajtoheshin me ndihmë ekonomike, aktualisht janë 2100. Veç kësaj muaj kanë hequr mbi 300

shkurt për të treguar forcën e shqiptarëve ndaj kësaj qeverie”, - ka vijuar fjalën e tij kreu i Bashkisë, duke u shprehur më tej: “Kjo qeveri ka qenë ekstreme me Bashkinë Kamëz, duke e diskriminuar në 0 fonde investime.

Në 4 vite qeverisje në Kamëz, vetëm 1 investim, restaurimin e qendrës shëndetësore që ka një vit që ka filluar dhe akoma s’ka përfunduar.

Ky moment duhet të shërbejë si moment reflektimi, pasi gjatë gjithë kësaj periudhe secili prej nesh është mbushur me mllef. Qytetarët mezi kanë pritur këtë moment për të protestuar ndaj kësaj qeverie”, - e mbylli fjalën e tij z. Mziu.



Fondi për shtresat në nevojë, pjesë e buxhetit 2017 të Bashkisë Kamëz

Shkurt 2017
GAZETA KAMZA



5

Bashkia Kamëz njofton të gjithë qytetarët e saj se ka miratuar në buxhetin e vitit 2017 fondin për mbështetje të politikave sociale për shtresat në nevojë, konkretisht politikën sociale "Për bonusin e strehimit social". Kjo nismë do të krijojë mundësinë e përballimit të kostos së qirasë për familjet më në nevojë, të cilat nuk kanë mundësinë financiare për të përballuar kostot e jetesës. Bashkia, nëpërmjet miratimit të fondeve të saj, u ofron zgjidhje reale këtyre shtresave, të cilat duhet të plotësojnë të gjitha kriteret e parashikuara në ligjin nr. 9232, datë 13.5.2004 "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane". Shpërndarja e këtij fondi do të bëhet sipas sistemit të pikëzimit për kategoritë e përcaktuara në ligj, sipas prioriteteve, sistem i cili është hartuar dhe miratuar në mbledhjen e fundit të Këshillit Bashkiak Kamëz për vitin 2017.



Mund të aplikojnë:

1. Individët që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe familjet e regjistruara në zyrat e gjendjes civile në njësinë e qeverisjes vendore përkatëse, të cilat, në momentin e aplikimit, plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikat 1, 2 e 3 të nenit 4 të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004 "Për programet sociale të strehimit të banorëve të zonave urbane", të ndryshuar, kanë të drejtë të paraqesin kërkesë për strehim në njësinë vendore, ku ata janë të regjistruar.

2. Familjet, të cilat kanë përfituar statusin e të pastrehut, sipas akteve ligjore në fuqi, para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, të ndryshuar, e që nuk janë trajtuar me strehim, duhet të paraqesin dokumentacionin, në përputhje me kërkesat e këtij vendimi.

3. Familja paraqet kërkesën për t'u trajtuar me strehim në çdo kohë, sipas formularit tip, që mund të tërhiqet pranë zyrave të Bashkisë në çdo kohë.

Klasifikimi i kërkesave për strehim bëhet nëpërmjet sistemit të pikëzimit, i cili miratohet nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore për çdo projekt më vete.

4. Familjet përfituese, pas marrjes së njoftimit, dorëzojnë në zyrat përkatëse dokumentacionin që mbështet deklaratimet e bëra në fazën e parë të aplikimit, sipas pikës 3 të këtij vendimi.

Dokumentacioni përmban:

-certifikatën e lindjes së aplikantit dhe certifikatën e gjendjes familjare;

-vërtetimin për vendbanimin në bashkinë ku kërkohet strehimi ose lejen e banimit, për familjet që kanë lëvizur nga zona të tjera të vendit;

-vërtetimin e të ardhurave neto të familjes;

-dokumentacionin përkatës nga punëdhënësi për detyrën dhe të ardhurat e aplikantit e të personave të tjerë të familjes, që janë në marrëdhënie pune;

-dokumentin nga organet tatimore dhe ato të sigurimeve shoqërore për derdhjen e kontributeve, për të gjithë anëtarët e vetëpunësuar të familjes;

-vërtetimin nga zyra e ndihmës dhe përkujdesjes pranë njësisë të qeverisjes vendore për anëtarët e familjes, të përfshirë në programin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës për personat me aftësi të kufizuara;

-vërtetimin nga zyra e punësimit e njësisë vendore përkatëse

për personat e përfshirë në programin e pagesës së papunësisë; -vërtetimin nga organet e sigurimeve shoqërore për personat në pension;

-vërtetimin nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme se familja apo ndonjë anëtar i saj nuk disponojnë në pronësi banesë a ndonjë mjedis, që mund të përdoret si e tillë;

-vërtetimin nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për sipërfaqen e pronës, që zotëron familja apo ndonjë anëtar i saj, kur banesa është me sipërfaqe nën normat në fuqi të strehimit;

-vërtetimin nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të vendit të origjinës se nuk figuron e regjistruar asnjë pronë, e cila mund të përdoret edhe për strehim, për familjet, që kanë ndryshuar vendbanim për efekt punësimi;

-dokumentin zyrtar të celebrimit dhe certifikatat personale, për efekt të llogaritjes së moshës, për çiftet e reja;

-vendimin e gjykatës, që i lë në ngarkim fëmijën ose fëmijët për çiftet e divorcuara;

-vërtetimin përkatës nga institucioni ku ka qenë i strehuar dhe librezën e jetimit, dhënë nga institucioni shtetëror i autorizuar, për individët me statusin e jetimit;

-vërtetimin e komisionit mjekësor të përcaktimit të aftësisë së kufizuar, për individë me aftësi të kufizuara, që trajtohen sipas shkronjës "i" të shkronjës "c" të nenit 5 të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004 "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane", të ndryshuar;

-dokumentin e lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për personat që kanë statusin "emigrant", punëtor emigrant" dhe "azilkërkues";

-dokumentin e lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për familjet e punonjësve të rënë në detyrë, që u përkasin Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe Policisë së Burgjeve;

-dokumentin e lëshuar nga institucionet përkatëse për viktimat e dhunës në familje.

Kamëz, në shkurt qeveria heq 300 familje nga ndihma ekonomike

Ja VKM-ja që kërcënon përfituesit e ndihmës ekonomike të moshës 35-70 vjeç të bëjnë Check up-in!


Kamza vazhdon të persekutohet nga qeveria "Rama". Jo vetëm që prej vitit 2013 nuk ka akorduar asnjë lek për investime, por çdo muaj vazhdon të largojë padrejtësisht nga skema e ndihmës ekonomike familjet përfituese. Në muajin shkurt, Shërbimi Social Shtetëror ka larguar nga skema e përfitimit të ndihmës ekonomike 300 familje në Bashkinë Kamëz.

Absurditeti është që këto heqje janë pa argument, sepse të njëjtat familje e kanë përfituar ndihmën deri më tani me të njëjtin numër pikësh.

Çuditërisht, tani këto familje njoftohen që nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme, edhe pse ato nuk kanë ndryshim në kushtet e jetesës së tyre social-ekonomike.

Pra, kuptohet qartë që ky është një sulm politik kundrejt Bashkisë dhe qytetarëve të Kamzës.

Qeveria është vënë në shërbim të koncesioneve të dhëna në kurriz të shqiptarëve, duke kërcënuar edhe familjet përfituese të kësaj ndihme. Më 7 dhjetor 2016, qeveria ka nxjerrë VKM me nr. 955 me anë të të cilës i detyron, "kërcënon" familjet përfituese të ndihmës ekonomike të bëjnë Check up-in. Ndonëse nuk e përmend konkretisht fjalën "Check up" më konkretisht në pikë 8 të VKM-së thuhet: "Strukturat e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor,



të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësorë, mjeku i familjes dhe administratori shoqëror, koordinojnë procesin e dhënies së ndihmës ekonomike duke bërë të mundur dhënien e informacionit për kryerjen e kontrollit mjekësor bazë për personat e grupmoshës 35-70 vjeç. Administratori shoqëror ka detyrimin të njoftojë tre muaj rresht para muajit të lindjes, personat e grupmoshës 35-70 vjeç që përfitojnë ndihmë ekonomike për kryerjen e kontrollit mjekësor bazë në një nga ditët e muajit të lindjes.

Personi i njoftuar është i detyruar të paraqitet në muajin pasardhës të muajit të lindjes me një vërtetim nga qendra shëndetësore që ka kryer kontrollin mjekësor bazë. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor brenda 7 ditëve kalendrike nëpërmjet strukturave rajonale të tij dërgon informacionin e nevojshëm pranë administratorit shoqëror". Kësaj i thonë të të kërcënojnë qeveria me bukën e gojës për Check up-in e qeverisë!

Prej vitit 2013, numri i familjeve që janë larguar nga skema e përfitimit të ndihmës ekonomike në Bashkinë është rreth 5 mijë familje. Edhe pse administratorët kanë bërë oponencën ligjore në sistemin elektronik, ndaj Kryeministrit dhe ministrit të linjës për rastet e refuzimit padrejtësisht, përsëri këto familje kanë mbetur pa u trajtuar.

Absurditeti është që këto heqje janë pa argument, sepse të njëjtat familje e kanë përfituar ndihmën deri më tani me të njëjtin numër pikësh. Çuditërisht, tani këto familje njoftohen që nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme, edhe pse ato nuk kanë ndryshim në kushtet e jetesës së tyre social-ekonomike.



Vijojnë projektet e Bashkisë Kamëz për përmirësimin e infrastrukturës urbane të qytetit

Rruga e Zanave në lagjen nr. 1 Bathore

Ndërtimi i Rrugës së Zanave në lagjen nr. 1 Bathore është një prej investimeve të Bashkisë Kamëz që do të realizohet vitin 2017. Ky projekt është një nga 50 projektet e reja të kësaj Bashkie. Me gjatësi 350 ml, Rruga e Zanave do t'u vijë në ndihmë mijëra banorëve të lagjes nr. 1 Bathore, por edhe atyre të lagjeve të tjera. Bashkia, duke u mbështetur vetëm në të ardhurat e veta, do të realizojë investime publike në infrastrukturën rrugore dhe në infrastrukturën nëntokësore në disa lagje të qytetit. Pjesë e këtyre ndërhyrjeve në



infrastrukturë, duke u bazuar edhe në kërkesat e banorëve, është edhe ndërtimi i Rrugës së Zanave. Projekti i hartuar nga specialistët e Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Investimeve Publike e Rrugëve përmban standarde bashkëkohore. Qytetarët e kësaj zone do të jenë kështu përfitues të një investimi të rëndësishëm, i cili do të ketë ndikim të madh social dhe ekonomik.

Kanalizimet në rrugën "Argjinatura" në lagjen 5 Bathore

Investimet e reja të Bashkisë Kamëz për vitin 2017 përfshijnë edhe ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura (KUN). Mes këtyre investimeve është edhe ndërtimi i KUN-së në rrugën "Argjinatura", që shtrihet në lagjen nr. 5 Bathore. Projekti që do të realizohet, ka një gjatësi prej 585 ml, në



të cilin do të përdoren tuba me përmasa Ø 500; Ø 600. Në një kohë kur nga qeveria e majtë në katër vjet nuk është ndërtuar asnjë metër rrugë apo kanalizime në gjithë vendin, në Bashkinë Kamëz, pavarësisht nga financimi zero i qeverisë, ka vijuar puna për realizimin e investimeve në infrastrukturë. Duke hartuar dhe duke zbatuar një buxhet social, Bashkia ka arritur që falë mirëmenaxhimit të të ardhurave, t'i kthejë ato në investime. Kështu, edhe projekti i mësipërm do të realizohet tërësisht me të ardhurat e vetë Bashkisë. Kjo, me qëllim për t'u ardhur në ndihmë banorëve të qytetit, të cilët kanë nevojë emergjente për këto ndërhyrje në infrastrukturë.

Rrugët "Torino" dhe "Bicaj" në lagjen 1 Bathore

345 ml do të jetë gjatësia tërësore e investimit që do të realizohet në segmentin rrugor "Torino" dhe "Bicaj". Këto dy rrugë, që do t'i nënshtrohen ndërhyrjes për ndërtimin e tyre me parametra të kohës, ndodhen në lagjen nr. 1 në Bathore. Gjerësia e rrugëve do të jetë 5 ml me bankina në të dyja anët me përmasa 0.5 ml. Ndërtimi i këtyre rrugëve i vjen në ndihmë një numri të konsiderueshëm familjesh të kësaj zone, duke qenë se ka një dendësi të madhe popullimi. Përveç krijimit të lehtësirave për kalimin e këmbësorëve dhe të automjeteve, investime të tilla ndikojnë edhe në zhvillimin e biznesit, gjë e cila ndikon pastaj në punësim dhe në rritjen e të ardhurave të vetë banorëve. Duke u nisur edhe nga ky

qëllim, Bashkia ka pasur përparësi të sajën krijimin e një infrastrukture të favorshme, si për qytetarët, familjet e tyre, por edhe për kompanitë private. Për këtë arsye dhe për shkak



të një pakete fiskale të favorshme shumë kompani kanë sjellë aktivitetet e tyre në territorin e Bashkisë Kamëz.

Kanalizimet dhe rruga "Australia" në Zall-Mner

Investimet e Bashkisë Kamëz për vitin 2017 do të vijojnë edhe në lagjen e Zall-Mnerit, ku së shpejti do të ndërtohen kanalizimet dhe rruga "Australia", me gjatësi 210 ml dhe gjerësi 4 ml. Qytetarët e kësaj zone do të jenë përfitues të një investimi të rëndësishëm, i cili do të ketë ndikim të madh social, pasi



bën të mundur përmirësimin e kushteve të infrastrukturës urbane dhe lehtësimin e kalimit në këtë segment. Gjithashtu, me ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve, i jepet fund edhe një problematike dhe shqetësimi të banorëve të zonës. Ndërkaq, me krijimin e një infrastrukture bashkëkohore, do të bëhet i mundur edhe zhvillimi i mëtejshëm i bizneseve. Si rrjedhojë, do të ketë më shumë të punësuar dhe më shumë përfitime financiare për banorët e kësaj rruge.

Rruga "Elez Isufi" në lagjen 1 Bathore

Ndërtimi i rrugës "Elez Isufi", projekt që do të zbatohet në këtë vit, do të ndikojë në përmirësimin e mëtejshëm të infrastrukturës urbane në lagjen 1 Bathore. Rruga "Elez Isufi", me gjatësi 506 ml, do të ketë gjerësi 4.5 ml, kunetë dhe trotuare 1 ml në të dyja anët e saj. Kjo rrugë shtrihet në një zonë që është shumë e populluar dhe ka një pozicion favorizues, për vetë faktin se lidh shumë banesa dhe u jep zgjidhje shumë problemeve, të cilat janë ngritur nga vetë qytetarët. Duke parë kërkesat dhe nevojat e tyre, Bashkia Kamëz ka përfshirë në



prioritetet e investimeve të saj edhe këtë rrugë, e cila do të financohet nga të ardhurat e vetë Bashkisë, meqenëse nga qeveria nuk është akorduar asnjë qindarkë për projektet, nga të cilat do të përfitonin banorët e Kamzës. Në këtë mënyrë vijon përmirësimi i infrastrukturës urbane në qytetin e Kamzës, gjë që përbën një ndër synimet kryesore të Bashkisë dhe të kryebashkiakut Xhelal Mziu.

Rruga "Strasburgu" në lagjen nr. 2 Kamëz

Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve në rrugën "Strasburg", në lagjen nr. 2 Kamëz, është një projekt tjetër i Bashkisë i vitit 2017. Zbatimi i këtij projekti u jep zgjidhje shumë problematikave dhe shqetësimeve të banorëve të zonës. Një prej këtyre shqetësimeve ka qenë edhe ndërtimi i kanalizimeve, që do të marrë zgjidhje me realizimin e investimit të Bashkisë financuar nga të ardhurat e veta. Gjatësia e segmentit rrugor



ku do të ndërhyhet është 345 ml dhe do të përdoren tuba me përmasa Ø 400. Bashkia Kamëz, si institucioni që ka lidhje të drejtpërdrejta me qytetarët dhe problematikave të tyre, ka hartuar dhjetëra projekte në fusha jetike. Një ndër të është edhe ndërtimi i kanalizimeve në rrugët e Kamzës dhe të Paskuqanit. Ashtu siç ka ndodhur edhe vitet e mëparshme, investimet publike do të jenë kryefjala e punës së Bashkisë, e cila jo vetëm në këtë zonë, por kudo në territorin e saj ka bërë të mundur dhjetëra projekte me ndikim të jashtëzakonshëm social.

Ndërtimi i rrugës "Gurrë" dhe i KUN-së në lagjen 2 Bathore

Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura dhe i rrugës "Gurrë" në lagjen 2 Bathore është një investim me rëndësi të madhe për komunitetin e banorëve që banojnë në këtë zonë. Duke pasur parasysh nevojat dhe shqetësimet e tyre, Bashkia Kamëz ka parashikuar që të ndërtojë rrugën dhe rrjetin e KUN-së në këtë segment rrugor. Rruga "Gurrë" ndodhet në lagjen nr. 2 në Bathore dhe segmenti ku do të investohet ka gjatësi 190 ml dhe gjerësi 4 ml. Duke pasur



parasysh që kjo zonë ka pasur probleme me kanalizimet, ndërtimi i kësaj rruge dhe i linjës së KUN-së do ta lehtësojë shkarkimin e ujërave të ndotura të zonës, duke pasur parametra bashkëkohorë, që i përshtaten zhvillimit të zonës dhe krejt qytetit të Kamzës. Gjithashtu, edhe ndërtimi i rrugës do të ndikojë në lëvizjen më të lehtë të banorëve dhe automjeteve që do të kalojnë aty. Në këtë mënyrë, vijon angazhimi i Bashkisë për të ndërtuar një infrastrukturë bashkëkohore në çdo cep të qytetit.



Bum investimesh në Paskuqan për vitin 2017

Në vitin e dytë që Njësia Administrative e Paskuqanit është bashkë me Kamzën, Bashkia e qytetit të gjashtë në vend ka parashikuar një bum investimesh në këtë zonë. Projektet e planifikuara për t'u zbatuar në Paskuqan janë më shumë se një vit më parë dhe shtrihen në lagje të ndryshme të kësaj zone. Më e rëndësishmja është se këto projekte do të kenë një ndikim të jashtëzakonshëm social. Kjo, për vetë faktin se investimet që do të realizohen, janë ndërhyrje që do të bëhen në infrastrukturën urbane, kryesisht në ndërtimin e rrugëve dhe në ndërtimin e kanalizimeve.



Kështu, ndër investimet e parashikuara për vitin 2017 në Paskuqan, është ndërtimi i rrugës "Arben Broci" dhe i kanalizimeve në lagjen Paskuqan 2 dhe te QTA; ndërtimi i rrugëve "Ejll Dedja", "Ismail Qemali", "Isuf Xhelili" në lagjen Paskuqan 2; ndërtimi i rrugës "Halim Xhelo" në lagjen Paskuqan 1; vazhdimi i shkarkimit të liqenit të Paskuqanit si dhe segmenti tjetër i rrugës "Arben Broci" në lagjen Paskuqan 2; ndërtimi i rrugëve "Avni Rustemi", "Gjok Doçi" në lagjen Paskuqan 2; ndërtimi i rrugës "Ymer Haxhi Prizreni" në Babrru-Shpat; ndërtimi i rrugës "Nënë Tereza" në Fushë-Kërçik; ndërtimi i rrugës "Veli Dede" si dhe kanalizimet në Fushë-Kërçik; ndërtimi i rrugës "Dile Marku" në Paskuqan 2; ndërtimi i rrugës "Konferenca e Bujanit" në Babrru; ndërtimi i rrugës "Bule Naipi" në Paskuqan 2; ndërtimi i rrugës "Isa Boletini" në Paskuqan 1; ndërtimi i rrugës "Leka i Madh" në Paskuqan 1; ndërtimi i rrugës "Ndoc Gjetja" në Babrru-Kodër; ndërtimi i rrugës "Tajar Zavalani" në Babrru-Shpat; ndërtimi i rrugës "Ajet Xhindoli" në Paskuqan 2, Vresht; ndërtimi i rrugës të shkarkimit i Bovillës, Babrru, Kodër e Kuqe. Ndërkaq, edhe investimet në kanalizime do të shtrihen në shumë zona të Paskuqanit. Mes tyre është ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura në lagjen Fushë-Kërçik; ndërtimi i kanalizimeve mbrapa xhamisë në Babrru-Qendër; ndërtimi i kanalizimeve në dy segmente në Kodër të Kuqe; ndërtimi i kanalizimeve në rrugën "Xhovani Fausti" te lagja Paskuqan 2; ndërtimi i kanalizimeve te rruga "Aleks Buda" në Paskuqan 2, Vresht; ndërtimi i kanalizimeve te rruga "Ago Agaj" në Paskuqan 2, Vresht; ndërtimi i kanalizimeve te rruga "Abdyl Elmazi" Paskuqan 2, Vresht; ndërtimi i kanalizimeve tek rruga "Abdyl Ypi" Paskuqan 2, Vresht.

Investimet në Paskuqan, së shpejti nis ndërtimi i rrugës "Arben Broci" bashkë me kanalizimet

Mes shumë projekteve që do të zbatohen në këtë zonë, është ndërtimi i rrugës "Arben Broci" në lagjen Paskuqan 2 bashkë me rritjen e kanalizimeve në këtë segment. Ky



investim merr një rëndësi të veçantë, jo thjesht për faktin se ka një gjatësi të konsiderueshme prej 685 ml, por sepse do të ketë infrastrukturë të plotësuar rrugore dhe infrastrukturë

nëntokësore. Gjithashtu, gjerësia e saj do të jetë 8 ml, me kunetë anash, si dhe me trotuare 2.5 ml në të dyja anët e saj. Përveç përmirësimit të infrastrukturës, realizimi i këtij projekti do të ndikojë edhe në zhvillimin e bizneseve ekzistuese, si dhe në çeljen e aktiviteteve të reja të sipërmarrjes së lirë. Prej kësaj do të përfitojnë qytetarët e kësaj zone, duke pasur më shumë mundësi për punësim dhe për rritjen e nivelit të jetesës.

Rruga "Burreli" në lagjen nr. 1 Bathore

Ndërtimi i rrugës "Burreli" në lagjen nr. 1 Bathore është një tjetër projekt i Bashkisë Kamëz i parashikuar për t'u zbatuar në vitin 2017. Megjithëse investimet e Bashkisë që nga viti 2007 kanë qenë të shumta në Kamëz, përsëri infrastruktura rrugore dhe ajo e kanalizimeve ka shumë nevojë për ndërhyrje. Një prej këtyre ndërhyrjeve është edhe investimi që do të realizohet në rrugën "Burreli", me gjatësi 270 ml dhe gjerësi 4.5 ml, e cila shtrihet në lagjen nr. 1 në Bathore. Megjithëse Bashkia Kamëz ka aplikuar me 130 projekte pranë institucioneve qendrore të qeverisjes, asnjë qindarkë



nuk është akorduar për këtë njësi. Këto projekte kanë pasur standardet e duhura për të merituar vlerësimin nga ana e këtyre institucioneve, por asnjë nuk është miratuar nga ana e institucioneve të qeverisjes qendrore, gjë që tregon edhe një herë indiferencën e kësaj qeverie ndaj qytetarëve dhe Bashkisë së Kamzës. Duke parë këtë indiferencë dhe këtë diskriminim të vazhdueshëm, Bashkia ka financuar me të ardhurat e veta çdo investim që është kryer në vitet e fundit.

Kanalizimet në rrugën "Viktor Hygo" në Frutikulturë

Së shpejti do të fillojë të ndërtohet edhe rrjeti i kanalizimeve në rrugën "Viktor Hygo" në lagjen Frutikulturë. Ky investim i Bashkisë Kamëz për vitin 2017 është mjaft i dobishëm për qytetarët e zonës. Ky projekt i Bashkisë Kamëz synon që të përmirësojë kushtet e jetesës së banorëve të zonës. Megjithëse ka një gjatësi prej 210 ml, zbatimi i projektit



ndikon pozitivisht te një numër i madh familjesh, pasi përbën një investim të rëndësishëm në kuadrin e ofrimit të shërbimeve sa më cilësore për qytetarët. Në këtë rrjet kanalizimesh do të përdoren tuba me përmasa Ø 300. Me këtë përgjegjësi dhe angazhim, Bashkia, si institucioni që ka lidhje të drejtpërdrejta me qytetarët dhe problematikat e tyre, ka hartuar dhjetëra projekte në fusha jetike. Një ndër to është

edhe ndërtimi i kanalizimeve në rrugët e Kamzës, por tashmë edhe të Paskuqanit. Janë 50 projekte që janë parashikuar të realizohen në vitin 2017 brenda territorit të Bashkisë Kamëz.

Rrjeti i KUN-së me gjatësi 850 ml në rrugën "Selenicë", lagja 5 Bathore

Në lagjen nr. 5 Bathore së shpejti do të ndërtohet rrjeti i kanalizimeve të ujërave të ndotura në rrugën "Selenicë". Ky është një tjetër investim që i shtohet kësaj zone. Segmenti ku do të ndërtohet rrjeti i KUN-së ka një gjatësi prej 850 ml. Me fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2017 Bashkia



Kamëz do të bëjë të mundur realizimin edhe të këtij projekti jetik për banorët, pasi me përfundimin e tij do të zgjidhet problemi i kanalizimeve. Ky investim i Bashkisë Kamëz do ta lehtësojë shkarkimin e ujërave të ndotura të zonës, duke pasur parametra bashkëkohorë, që t'i përshtaten zhvillimit të zonës. Për të gjithë segmentin ku do të investohet, do të përdoren tuba me përmasa Ø 400, Ø 500; si dhe mbushje e plotë e kanalit të KUN-së me zhavorr.

Vahdimi i rrugës "Liria" në Frutikulturë

Bashkia Kamëz ka bërë të mundur hartimin e projektit për fazën e dytë të ndërtimit të rrugës "Liria". Kjo pjesë e rrugës gjendet në lagjen Frutikulturë. Ajo kufizohet me rrugën "Skënderbeu" dhe me "Bulevardin Blu" (nëpërmjet segmentit të parë të rrugës "Liria", që ka përfunduar së ndërtuari), duke qenë kështu pjesë e një rrjeti të rëndësishëm rrugor që



bën lidhjen e disa lagjeve në Kamëz. Projekti i hartuar merr parasysh rehabilitimin kompleks të rrugës, duke synuar të përmirësojë objektivin e Bashkisë Kamëz për rehabilitimin e infrastrukturës së rrugës në tërësinë e vet, duke përfshirë të gjithë parametrat e infrastrukturës rrugore. Vazhdimi i rrugës "Liria" ka një gjatësi më shumë se 1 km (1119 ml), gjerësi 10 ml, kunetë dhe trotuare 2.5 ml në të dyja anët e rrugës. Ndërtimi i segmentit të dytë të rrugës "Liria" është ndër më të rëndësishmit që ka hartuar Bashkia Kamëz për përmirësimin e infrastrukturës rrugore.

Kjo, për vetë faktin se ky segment rrugor bën lidhjen e mijëra banorëve të Kamzës. Realizimi i projektit do të bëjë të mundur jo vetëm lehtësimin e lëvizjes së këmbësorëve dhe të automjeteve, por do të jetë një shkak më shumë që kjo zonë të zhvillohet më tej, duke qenë se mund të shtohet numri i bizneseve të reja që do të hapen dhe do të zhvillohen më shumë ato ekzistueset. Për rrjedhojë, kjo gjë do të sjellë edhe rritjen e numrit të të punësuarve dhe mirëqenien e komunitetit.



Kamza vijon e pandalshme rrugëtimin drejt Superligës, fiton edhe me Kastriotin, Rezi vendimtar

Kamza vijon arratinë dhe konsolidon edhe më shumë pozitën në kreun e klasifikimit, duke udhëhequr e vetme në vendin e parë. Ekipi kamzali "fluturon" drejt Superligës me golin e Ermir Rezit, ndeshje e cila u luajt në kuadrin e javës së 15-të në grupin A të Kategorisë së Parë.

Falë golit të sulmuesit Rezi, i cili ishte goli i gjashtë për të në këtë sezon, skuadra drejtuar nga trajneri Bledar Devollit mundi Kastriotin 0-1, në transfertë, për ta çuar në 10 pikë diferencën me ndjekësen më të afërt, Besëlidhjen e vendit të dytë.

Në minutën e 15-të të sfidës së luajtur në Krujë, sulmuesi i talentuar i Kamzës, nuhatës i mirë i golit, u gjend në vendin dhe kohën e duhur pas goditjes së Mario Morinës, duke shfrytëzuar topin e mbetur në zonën e portierit dhe duke kaluar Kamzën në epërsi.

Skuadra e Kamzës pati mundësinë e

artë për të realizuar golin e dytë vetëm dy minuta më pas me anë të një penalltie, por sulmuesi Morina gaboi nga pika e bardhë e 11-metërshit dhe nuk arriti ta dërgonte topin në rrjetë. Në fund të pjesës së parë Kamza humbet një tjetër rast të pastër për të dyfishuar rezultatin, pasi Rezi autori i golit të vetëm të takimit, asistoi pikërisht Morinën që u gjend i vetëm përballë portierit, topi i goditur prej tij përfundoi jashtë.

Pjesa e dytë ka qenë më e vakët në raste për të dyja skuadrat. Gjatë pjesës së dytë kamzalinjtë janë munduar për të administruar epërsinë e arritur në pjesën e parë, duke marrë tri pikë shumë të rëndësishme në një transfertë dhe të ruajë kryesimin në grupin A të Kategorisë së Parë.

Me këtë fitore, skuadra e Kamzës vijon e pandalshme rrugëtimin për të arritur objektivat sezonalë.



Kamza Basket e nis me fitore fazën e dytë, mund Teutën në transfertë 78 - 86



Kamza Basket e ka nisur me fitore fazën e dytë të Kampionatit Kombëtar, duke mundur në transfertë një rival direkt për titull, Teutën, 86-78 në pallatin e sportit "Ramazan Njala". Ndeshja është zhvilluar në kuadrin e javës së 11-të. Takimi mes Teutës dhe Kamzës ishte me rivalitet dhe emocione, por miqtë kamzalinj ishin më konkretë në parket, duke arritur një fitore me vlera. Loja ka qenë e hapur dhe e ekuilibruar, me Kamzën e cila është treguar më e saktë në kosh. Kamza Basket ka qenë e vendosur mjaft mirë në parket dhe ka mbyllur me efikasitet hapësirat për kundërshtarin. Lojë me shumë efikasitet për Kamzën kanë zhvilluar Llazani, Vaqarri dhe Çela. Me gjithë përpjekjet e Teutës, ndeshja është mbyllur me fitore për ekipin mik të Kamzës.

Kjo është një fitore shumë e rëndësishme për ekipin e Kamzës për vazhdimësinë e kampionatit. Edhe pse në përbërjen e skuadrës ka lojtarë të rinj, fokusi i punës është që në të ardhmen këta basketbollistë të talentuar t'i shërbejnë jo vetëm skuadrës së Kamzës, por edhe ekipit kombëtar.

Këtë sezon gara për titullin kampion është rritur shumë, duke parë edhe merkaton e fuqishme që kanë bërë ekipet kryesore, trajneri Adem Muhametaj çdo ditë po punon shumë me basketbollistët e tij, duke pasur në gjirin e ekipit të Kamzës sportistë të talentuar nga ky qytet, nga zona të ndryshme të tij.

Java e 11-të / Teuta - Kamza Basket 78-86 (23-32, 22-16, 11-18, 22-20)

BASHKIA KAMËZ

Informacione	Çmime Ndërkombëtare	Partneritete
<ul style="list-style-type: none"> • Sipërfaqe 40.357.000 m² • Popullsia mbi 140,000 • Atraktive për biznesin, mbi 2400 • Moshë mesatare 27 vjeç • Sistem i plotë adresash • Rrugë të asfaltuara mbi 160 km • One Stop Shop • Pallati i Kulturës, Stadiumi etj... 	<ul style="list-style-type: none"> Bashkia me praktikat më të mira kërkimore, ESQR Bruksel 2014 "Çmimi i Sokratit" EBA Oxford 2014 Menaxhuesi më i mirë i qytetit 	<ul style="list-style-type: none"> Bashkimi European Banka Botërore USAID KfW GIZ Macerata, Itali Jena, Gjermani Galway, Irlandë
Kontakte		
<p>www.kamza.gov.al</p> <p> bashkiakamez</p> <p> xhelalmziu</p>		
<p>Adresa: Bulevardi "BLU" Nr 492 Kamez, tel: +355 47 200 177, e-mail: bashkiakamez@gmail.com, www.kamza.gov.al</p>		